



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.11.2019, ora 15:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – Kryetare e komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimin e procesverbaleve të datave 18 tetor, 6, 11 dhe 12 nëntor 2019.
2. Shqyrtimi në parim dhe paraqitja nga ministri në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” .

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Vasil Sterjovski, Alket Hyseni, Ligoraq Karamelo, Ediola Braha, Adnor Shameti, Eglantina Gjermani, Vasilika Hysi, Ervin Bushati, Zef Shtjefni, Reme Lala dhe Elona Hoxha.

Mungojnë:

Ralf Gjoni, Fatmir Velaj, Rudina Hajdari, Halit Valteri, Andrea Marto, Evis Kushi, Ditmir Bushati dhe Eglantina Gjermani.

Të ftuar:

Gent Cakaj - Ministër në Detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme

Armand Skapi - Sekretar i Përgjithshëm i MEPJ-së

Ilda Dega - Drejtoreshë e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë me mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme të datës 22 nëntor 2019.

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 18 tetor, 6, 11 dhe 12 nëntor 2019 dhe shqyrtimin në parim dhe paraqitje nga ministri në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.

Të ftuar kemi zotin Gent Cakaj, ministër në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme, zotin Armand Skapi, sekretar i Përgjithshëm i MEPJ-së dhe Ilda Degën, drejtoreshë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. Mirë se erdhët!

Pa humbur kohë fillojmë me miratimin e procesverbaleve të datave 18 tetor, 6, 11 dhe 12 nëntor. A ka vërejtje për procesverbalet? Nuk ka vërejtje.

Miratohet.

Kalojmë te shqyrtimi në parim. Paraqitja e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” do të bëhet nga ministri në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Zoti Cakaj, fjala për ju.

Gent Cakaj – Faleminderit!

Jam tërësisht i nderuar që jam sot këtu dhe kam nderin ta paraqes projektbuxhetin e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme për vitin 2020. Ashtu siç e thatë, unë jam i shoqëruar nga sekretari i Përgjithshëm, zoti Skapi dhe drejtoresha e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar, zonja Ilda Dega. Natyrisht, këta janë në dispozicion për të ofruar përgjigje më teknike dhe më të detajuara, nëse është nevoja.

Buxheti i vitit 2020 është pjesë e planifikimit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe është i mbështetur në 4 programe buxhetore.

Shtylla e parë është planifikimi, menaxhim-administrim, e dyta, mbështetja diplomatike jashtë shtetit, e treta, aktiviteti diplomatik dhe konsullor. E katërta, natyrisht si objektivi më madhor i politikës së jashtme, mbështetja për integrimin europian. Në total buxheti i planifikuar është 3 miliardë e 363 milionë e 380 lekë, kurse rritja, në krahasim me vitin e kaluar është afërsisht 455 milionë lekë dhe në terma absolutë parashikohet të jetë një rritje 14,3% krahasuar me vitin e ardhshëm. Kjo rritje vjen edhe si pasojë e zgjerimit të vëllimit të aktiviteteve të diplomacisë shqiptare për vitin që vjen. Buxheti është i dizenuar për mundësimin e kryerjes së funksioneve logjistike, organizative operative të Ministrisë së Jashtme, po ashtu edhe për përmbushjen e objektivave madhorë që kemi.

Realisht, po fokusohem vetëm në katër shtylla dhe, nëse ka interes shtesë, jam i gatshëm të përgjigjem. Janë angazhimet tona në rajon, angazhimi jonë për integrimin europian, angazhimi ynë në kryesimin në vitin e ardhshëm të OSBE-së dhe, natyrisht, përpjekja jonë për të siguruar vendin e një anëtarit jo të përhershëm në Këshillin e Sigurimit për vitin 2022.

Theksoj se përpjekja jonë për çeljen e negociatave vazhdon për vitin tjetër dhe, natyrisht, do të zërë vend qendror në angazhimet diplomatike të qeverisë shqiptare. Natyrisht, në rast të hapjeve të negociatave vitin e ardhshëm, presim alokimet e buxhetit shtesë për të përballuar vëllimin e shtuar të punës. Nga ana tjetër, në këtë buxhet theksoj se janë afërsisht 4 milionë dollarë shtesë ekskluzivisht të dedikuara për kryesinë shqiptare të OSBE-së, por kjo është vetëm në një buxhet fillestar dhe, kurrësi, nuk përbën shumën totale të shpenzimeve që do t'i kemi në kryesimin e OSBE-së vitin e ardhshëm. Këtu kryesisht parashikohen shpenzimet operative, organizimi i konferencave dhe mbulimi i aktiviteteve të tjera politike, deri në konferencën ose ministralin e fundvitit të ardhshëm. Bazuar në praktikën e vendeve të tjera, qeveria e Shqipërisë është e gatshme të alokojë fondin shtesë për ministralin vitin tjetër. Pak a shumë, këta janë objektivat politikë, të cilët pritet të mbulohen në këtë buxhet dhe unë mbetem në dispozicionin tuaj për t'iu përgjigjur pyetjeve shtesë, në mënyrë që ky diskutim të jetë më interaktiv.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Cakaj!

Zoti Ervin Bushati, si relator keni fjalën.

Ervin Bushati – Faleminderit, zonja kryetare!

Projektbuxheti i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme është pjesë e planifikimit buxhetor afatmesëm në periudhën 2020-2022. Prioritetet e politikës për vitin 2020 janë paraqitur në relacionin shoqërues të projektligjit, si më poshtë:

Hapja e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Europian; zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me vendet e tjera, me prioritet marrëdhënien me partnerët strategjikë dhe vendet fqinje, vazhdimi i angazhimit për njohjen e mëtejshme ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, për pjesëmarrjen dhe anëtarësimin e saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare; funksionalizimi dhe mbështetja e punës së dy nismave rajonale me seli në Tiranë, Zyrë Rajonale për Bashkëpunimin Rinor dhe Fondi i Ballkanit Perëndimor, si dhe në tërësi sigurimi i pjesëmarrjes aktive në bashkëpunimin shumëpalësh rajonal; kryesimi i disa nismave rajonale dhe organizatat ndërkombëtare, pjesëmarrja aktive dhe realizimi i kontributit të Republikës së Shqipërisë në kuadër të NATO-s; zbatimi i detyrimit të anëtarësimit në organizatave dhe forumet shumëpalëshe, ku jemi edhe ne palë; plotësimi i

bazës ligjore të bashkëpunimit me vendet e tjera; forcimi dhe rritja e rolit të diplomacisë publike ekonomike dhe diasporës në shërbim të interesave ekonomike të Shqipërisë; promovimi i potencialeve për investime, tregti dhe bashkëpunimet ekonomike, tregtare dhe kulturore me partnerët tanë ndërkombëtarë dy dhe shumëpalësh; realizimi i një shërbimi konsullor të mbështetur në profesionalizëm eficient, transparencë dhe përgjegjshmëri; zhvillimi i kapaciteteve profesionale të stafit, të ministrisë dhe përfaqësive për procesin e negociatave. Në parashikimin e projektbuxhetit të vitit 2020, sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore, është parashikuar që Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, të ketë një total të shpenzimeve buxhetore prej 3,636 miliardë lekësh.

Rritja buxhetore për vitin 2020, në krahasim me vitin 2019, është në vlerën prej 455 dhe 880 milionë lekësh, atë që përmendi edhe ministri në detyrë me rastin e organizimit të eventit me OSBE-në. Ndërkohë, të gjitha synimet dhe objektivat e shërbimit të jashtëm, pavarësisht mos rritjes së tavanëve buxhetore, në krahasim me vitin e kaluar, do të mbulohen falë një miradministrimi të burimeve financiare dhe kapaciteteve njerëzore në dispozicion për vitin 2020. Numri i parashikuar i punonjësve për vitin 2020 është 565, pra 14 punonjës më shumë se sa në vitin 2019.

Për sa më sipër, orientuar nga prioritetet e politikës së jashtme, vlerësojmë se projektbuxheti i vitit 2020 mundëson kapacitetet e nevojshme të mbështetjes financiare me qëllim mbylljen e reformave të nisura gjatë viteve të mëparshme dhe realizimin e objektivave të reja për këtë ministri.

Meqenëse jemi te pjesa e prezantimit, unë kisha një pyetje, në qoftë se mund të procedoj zonja kryetare?

Mimi Kodheli – Jo, zoti Bushati, do të mbarojmë me prezantimin tuaj dhe më pas do të kalojmë te pyetjet, në qoftë se keni mbaruar me relacionin?

Ervin Bushati - Po!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Atëherë, kalojmë te pyetjet.

Dje kishim të njëjtin diskutim me zonjën Gjermani dhe menduam ta zbatojmë rregulloren në mënyrë strikte.

Urdhëroni!

Më pas fjalën e ka zoti Shtjefni.

Ervin Bushati – Vitin e kaluar ne miratuam dhe kemi prezantuar një rritje të pagave në masë të caktuar, sipas pozicionit që kanë në Ministrinë e Jashtme, në fakt, e kërkuar, e lobuar dhe e merituar mendoj. Dua të di, dhe këtë pyetje po bëjmë në të gjithë sektorët dhe të

gjitha ministrisë përkatëse të linjës: këto iniciativa që kemi ndërmarrë (pra efektet që kanë pasur shumë herë mund të mos të jetë edhe i matshëm në mënyrë kuantitative, por, megjithatë, me rritjen e përgjegjësisë dhe të angazhimit të stafit, të cilët kanë përfituar nga nisma, shpeshherë ne ndërmarrim nisma pas një kërkesë të vazhduar apo qoftë edhe një premtimi që ne kemi dhënë në programin tonë, patjetër duam të shikojmë këto iniciativa, qoftë fiskale që paraqiten në paketë apo rritje të buxheteve si kanë performuar) sa e kanë rritur performancën në këtë sektor dhe si e kanë incentivuar të gjithë sektorin për të performuar më mirë? Në këtë rast ambasadat, tona konsullatat, pra prezantimi ynë dinjitoz në të gjitha vendet, që kemi marrëdhënie shumëpalëshe dhe dypalëshe.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Ju rikujtoj, kolegë të komisionit, që ditën e hënë, në orën 9:00, ne do t'i rikthehemi diskutimit të buxhetit të Ministrisë së Jashtme nën për nen, ku do të jenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave. Kështu që për çdo gjë teknike apo për ndonjë specifikim, pra nuk ka të bëjë me diskutimin në parim dhe në përgjithësi, jeni të lutur që këtë ta bëni ditën e hënë.

Zoti Shtjefni, fjala për ju.

Zef Shtjefni – Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti Ministër, kam dy-tri pyetje për ju.

Zoti Ministër, që kur ju morët detyrën si ministër i Jashtëm në detyrë, ju keni bërë një reformë, gjatë asaj reforme dhe deri më sot të paktën që, kur keni marrë detyrën, a i keni shtuar shpenzimet në ministri apo i keni ulur shpenzimet?

Së dyti, gjatë ushtrimit të detyrës suaj ju keni hequr disa pasaporta diplomatike dhe pasaporta të shërbimit. Pra, i hoqët, sepse ishin dhënë në kundërshtim me ligjin apo i hoqët, sepse ua dhatë disa të tjerëve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Së treti, për buxhetin e vitit 2020 ju keni planifikuar një rritje të lehtë, sepse do të marrim si vend kryesimin e OSBE-së dhe thoni se do të shtojmë 14 punonjës. A mund të na informoni për diçka më shumë, zoti Ministër?

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Shtjefni!

Përpara se t'ia jap fjalën nënkryetares Hysi, ju ftoj, zotërinj përfaqësues të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, që të jepni përgjigje për çështjet e buxhetit, për të gjitha çështjet e tjera, për të cilat ka interes dhe ka pyetje nga kolegët. Ne ju kemi ftuar në një

seancë më vete që të mund të diskutojmë në lidhje me fushën që ju mbulon, kështu që mund ta rezervoni për një kohë të dytë përgjigjen, kjo është në gjykimin tuaj.

Zonja Hysi, fjala për ju.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Ministër i Jashtëm në detyrë!

Kemi lexuar me vëmendje pjesën e buxhetit për vitin 2020, por njëkohësisht, edhe relacionin që kam përgatitur shërbimet e komisionit. Më bie në sy fakti që ka një rritje të buxhetit vetëm për të mbuluar kostot që do të ketë Shqipëria gjatë kryesimit të OSBE-së dhe një rritje të numrit të punonjësve. Pra, 14 punonjës më shumë se viti 2019. Rritja e numrit të punonjësve është për efekt të kryesimit që ne do të marrim në OSBE, apo do t'i keni edhe në vijimësi?

Pyetja e dytë ka të bëjë me një ligj të posaçëm të miratuar kohë më parë. I kemi ngarkuar Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme regjistrimin e shtesave shqiptarë me vendbanim jashtë kufijve të Shqipërisë dhe ka pasur një buxhet jo shumë të lartë, por të konsiderueshëm. Dua të di nëse ky buxhet është përdorur për vitin 2019 dhe, nëse nuk është përdorur sipas rregullave të buxhetit, buxhet nuk mund të transferohet, por ai duhet planifikuar përsëri për vitin 2020, nëse e kam të saktë. Në këtë buxhet dua të di: si ka ecur ky proces dhe nëse ky buxhet është i mjaftueshëm për ta mbyllur këtë proces në vitin 2020?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja nënkryetare!

Zoti Cakaj, a keni dëshirë të merrni një grup pyetjesh dhe të përgjigjeni, apo do t'i merrni të gjitha pyetjet dhe në fund do të përgjigjeni?

Gent Cakaj – Si të jetë më e përshtatshme për ju, unë jam dakord.

Mimi Kodheli - Si të doni ju?

Në rregull, përgjigjuni këtij grupi pyetjesh dhe më pas u mbetet e drejta kolegëve të tjerë për të pyetur.

Faleminderit!

Fjala për ju, zoti Cakaj.

Gent Cakaj – Në rregull, rritja e numrit të punonjësve në Ministrinë e Jashtme lidhet drejtpërdrejt me kryesimin e OSBE-së. Janë shtuar 14 punonjës, të cilët janë pjesë e task forcës, që menaxhon të gjithë procesin e kryesimit të OSBE-së në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Për sa ai përket çështjes tjetër që ngritët, buxheti i planifikuar është 135 milionë lekë dhe do të shpenzohet vitin e ardhshëm.

Në lidhje me motivacionin që është krijuar si rrjedhojë e rritjes së pagave, është tepër e vështirë të kemi një matje të saktë ose një identifikim të korrelacionit midis rritjes së pagave dhe motivimit, meqenëse ka pasur një sërë masash që realisht kanë qenë në shërbim të motivimit të stafit, duke filluar nga dhënia në përparësi në emërime jashtë rritja e disiplinës së brendshme, krijimi i një sistemi më rigoroz të vlerësimit të performancës së punonjësve. Natyrisht, rritja e pagave ka qenë një motiv shtesë për performancën më cilësore, qoftë në paraqitjen e tyre politike-diplomatike, qoftë në kapacitetin e tyre për të përballuar shpenzimet, kryesisht në vendet që shërbejnë.

Pjesa tjetër nuk ishte e ndërlidhur drejtpërdrejt me çështjen e buxhetit, por nëse ka nevojë, unë jam i gatshëm të përgjigjem ose jam i gatshëm të vijë në një takim tjetër dhe të sqaroj çdo çështje që lidhet qoftë me pasaportat, qoftë me shpenzime të tjera që ndërlidhen me largimin e disa punonjësve, që kanë qenë të emëruar jashtë karrierës diplomatike.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Shtjefni, nuk logjikohet në këtë formë.

Fjalën e ka zoti Karamelo.

Më pas fjalën e kanë zoti Sterjovski, zonja Kushi dhe zonja Gjebrea.

Ligoraq Karamelo – Faleminderit, zonja kryetare!

I nderuar zoti Ministër në detyrë, kënaqësi që të kemi midis nesh, megjithëse dëshira ka qenë më e hershme që t’ju kishim pranë nesh. Para gati 5 muajsh kam kërkuar, bashkë me mbështetjen e kryetares, që ju te jeni prezent në Komisionin e Jashtëm, ndoshta edhe ministri i Jashtëm kushtetues. Që në fillim dua të them se, personalisht, konstatoj, por ndoshta edhe komisioni, edhe opozita, një nënvlerësim të këtij komisioni. Kërkesa që kemi bërë për t’u paraqitur parashtron një problematikë që ka nevojë për sqarim. Megjithatë, ndoshta është jashtë temës së buxhetit, dhe unë dua të përqendrohem te disa pyetje që kanë të bëjnë me dikasterin, në të cilin ju jeni emëruar për ta drejtuar.

Së pari, me aq sa jam në dijeni, por edhe nga përvoja disavjeçare, ekziston një strategji për shërbimin diplomatik të Shqipërisë dhe në, bazë të kësaj strategjie, disa shtylla kryesore të saj kanë të bëjnë me zgjerimin, efikasitetin dhe me intensifikimin e veprimtarive diplomatike jashtë shtetit. Konkretisht e kam fjalën në drejtim të aspektit qoftë të selive diplomatike, qoftë të trupit diplomatik. Nuk e di cili është efektiviteti i ambasadave që kemi sot jashtë vendit? A janë të gjitha efektive, apo ndihet që disa janë të tepërta, ose kanë nevojë për t’u zgjeruar dhe për t’u shtuar?

Së dyti, disa seli të ambasadave, me aq sa jemi në dijeni, ndoshta për mungesë të investime janë jashtë standardeve ose nuk janë në kushte optimale. Pa dyshim që ky duhet të jetë një prioritet i buxhetit të vitit të ardhshëm.

Një tjetër problem është edhe fakti që ju në mbështetjen e shërbimit diplomatik jashtë shtetit keni shtuar një numër të konsiderueshëm në fondin e pagave. Nuk e di pse vjen kjo dhe ku konkretisht konsiston. Fakti që nuk ka para për vitin e ardhshëm dihet dhe po e kuptojmë që buxheti i vitit të ardhshëm është një buxhet që të gjithë do të shtrëngojmë xhepat dhe do të shtrydhen ato; kuptohet ministritë që do t'i kenë. Unë gjykoj se në rastin e shërbimit diplomatik, në drejtim të disa aspekteve, ka nevojë për një mbështetje më të fuqishme financiare.

Së pari, ju prekët disa drejtime kryesore që kanë të bëjnë me integrimin, me OSBE-në, me NATO-n e me radhë. Nuk e dimë, a ka shtesë të buxhetit në këtë drejtim, apo OSBE-ja do të bëhet vetëm me fondet e taksapaguesve shqiptar, apo do të kemi edhe financimet tuaja?

Problemet që keni me Ministrinë e Diasporës... Dje konstatuam që janë disa paralelizma, që ekzistojnë në buxheti për sa u përket disa zërave ekonomikë dhe nuk e dimë a janë përcaktuara qartë ato fonde. Konkretisht, ku do të shkojnë për ju dhe ku do të shkojnë për problemin e diasporës?

Pyetja e fundit që unë kam, ka të bëjë me problemet që lidhen për integrimin. Pa dyshim, është një objektiv madhor dhe personalisht jam i prirur për ta mbështetur këtë. Ju sugjeroni që të ketë një shtim ose një insentifim të këtij drejtimi kaq madhor të vendit. Ne jemi të gatshëm ta mbështetim, qoftë duke votuar edhe për mbështetje financiare.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Urdhëroni, zoti Sterjovski!

Vasil Sterjovski – Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti Ministër në detyrë, kam dy pyetje.

Pyetja e parë ka të bëjë me ligjin për pakicat dhe mbrojtjen e pakicave në Republikën e Shqipërisë. Në vitin 2014 Kryeministri ka ngritur një grup ndërinstitutional. Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme e ka drejtuar këtë grup ndërinstitutional për të vlerësuar kuadrin ligjor dhe politikën për minoriteteve. Në kuadrin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European.

Në vitin 2017 parlamenti miratoi ligjin për mbrojtjen e pakicave kombëtare, dhe u tha që brenda 6 muajve do të miratohen të gjitha aktet nënligjore që ky ligj të ishte i zbatueshëm. Kanë kaluar 2 vjet dhe ky ligj ende nuk zbatohet, sepse nuk janë miratuar aktet nënligjore për

zbatimin e tij. A jeni në dijeni ju si ministri se ku ka ngecur puna dhe pse nuk miratohen aktet nënligjore që ky ligj të zbatohet?

Pyetja e dytë lidhet me kërkesën e banorëve të Bashkisë së Pustecit, që është një kërkesë e kahershme, për hapjen e një pike kufitare mes Shqipërisë dhe Greqisë në zonën e Prespës, në fshatin Cerie. Kjo pikë kufitare do të lidhë Shqipërinë me Greqinë, në pjesën e liqenit të Prespës, i cili shtrihet mes tri shteteve.

Përpara një viti qeveritë e Maqedonisë dhe Greqisë nënshkruan një marrëveshje për hapjen e një pike kufitare me fonde të BE-së, ku do të zhvillojnë infrastrukturën në pjesën tjetër të kufirit. Pra, me hapjen e pikës kufitare mes Shqipërisë dhe Greqisë, liqeni i Prespës do të lidhej me 3 pika kufitare, kjo zonë do të zhvillohej, por edhe qarku i Korçës, do të kishte impakt në shtimin e turistëve.

Kjo nuk është një kërkesë vetëm e banorëve të bashkisë Pustec, por të tre kryetarëve të bashkive, pra Bashkisë së Restës në Maqedoni, Bashkisë së Prespës në Greqi dhe Bashkisë së Pustecit në Shqipëri, të cilët kanë vite që kërkojnë të hapen këto pika kufitare. Maqedonia dhe Greqia e kanë mbyllur pjesën e tyre, por mbetet pjesa mes Greqisë dhe Shqipërisë që të mbyllet, që i gjithë ky rajon të lidhet dhe të ketë një zhvillim më të madh.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Zonja Kushi, fjala për ju.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit, zoti Cakaj për prezantimin tuaj!

Pyetja ime ka lidhje me një nga pyetjet që zoti Karamelo parashtrroi. Në prioritetet e politikës së jashtme për vitin 2020, siç janë paraqitur në relacionin që shoqëron projektbuxhetin, një nga prioritetet lidhet me forcimin dhe rritjen e rolit të diasporës në lidhje me interesat ekonomike të Shqipërisë, me promovimin, potencialet, investimet e kështu me radhë. Ky objektivi është edhe prioritet i punës së ministrit të shtetit për Diasporën. Në fakt, që kur miratuam ligjin për diasporën, e kemi diskutuar që ka disa kompetenca të dubluara dhe kemi pasur goxha diskutime atëherë. Unë dua të di: a koordinoheni, në përgjithësi në punën tuaj të përditshme, me ministrin për Diasporën, veçanërisht në hartimin e buxhetit për vitin 2020? Kjo është e rëndësishme, sepse duhet që aty ku objektivat janë të përbashkëta të ketë sinergji, pra ministrinë të koordinohen bashkë në mënyrë që objektivat të realizohen me sa më pak buxhet.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Po, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Cakaj!

Të nderuar anëtarë të strukturës së Ministrisë së Jashtme,

Duke qenë se jam anëtare e delegacionit parlamentar të OSBE-së dhe anëtare e Byrosë së Asamblesë Parlamentare, vlerësoj se viti 2020 do të jetë një vit shumë i rëndësishëm për Shqipërinë, sigurisht që është një sfidë e madhe, por edhe një mundësi unike për të pasur presidencën e radhës së OSBE-së.

Në relacionin që ka ardhur është e përshkruar parashikimi i buxhetit tuaj për kryesimin e OSBE-së. Këtë relacionin besoj se e bën Ministria e Financave, por te prioritetet e viteve 2020 – 2022, te politika e jashtme nuk është e përmendur fare. Aty përmenden hapja e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Europian, pjesëmarrja në kuadër të NATOS, ndërsa pjesa e OSBE-së nuk është përmendur, pavarësisht se në relacionin tuaj është, prandaj, pa dyshim që është e përfshirë edhe në buxhet. Pra, mirë do të ishte që të jetë.

Buxheti i Ministrisë së Jashtme operon me katër programe buxhetore, unë dua të di se në cilat nga këto programe është e përfshirë mbështetja për OSBE-në.

Së fundi, dua t'ju garantojmë mbështetjen që do të japë delegacioni parlamentar, sigurisht unë jam në cilësinë e anëtares së delegacionit edhe si anëtare e Byrosë, për sa i përket të gjithë procesit dhe punës që do të bëjë vendi ynë në këtë ndërmarrje të rëndësishme.

Mimi Kodheli – Zonja Gjermani, fjala për ju!

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit, zoti Cakaj!

Në vazhdim të pyetjes që sapo bëri kolegja Gjebrea, duke vlerësuar së tepërmi rëndësinë e jashtëzakonshme, unë them që është një ngjarje historike që Shqipëria merr kryesinë e OSBE-së dhe është përgjegjësi dhe angazhim. Ju keni parashikuar shtimin e stafit, ndërkohë që edhe shpenzimet për këtë vit, për ministrinë që ju drejtoni, realisht janë rritur. A përballohet e gjithë puna për marrjen e kësaj përgjegjësie me këtë buxhet që kemi këtu? Më duket sikur ju dëgjova që thatë: “Nëse do të ketë nevojë për financa të tjera, qeveria do të alokojë të tjera”. Nëse ka hapësirë apo mundësi që ne si komision të kërkojmë të rishikohet buxheti, pra t'ju shtohet për ta marrë përsipër këtë gjë, sepse e cilësojmë se ka një rëndësi të jashtëzakonshme, ju lutem na e thoni që ne t'ju mbështesim në këtë nismë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – A ka pyetje të tjera? Meqenëse nuk ka pyetje të tjera, edhe mua si anëtare e këtij komisioni më lind e drejta të bëj pyetje në fund. Unë dua të insistoј në të njëjtën pyetje që paraqitën shumica e kolegëve lidhur me shpenzimet e vitit që vjen për

presidencën e Shqipërisë në strukturën e OSBE-së. Në gjykimin dhe vlerësimin tim si financiere më rezulton që paratë e shtuara në buxhet, për shkak të pozicionit që do të ketë Shqipëria vitin tjetër, janë më pak se gjysma e asaj që realisht do të keni nevojë.

Shuma shtesë që ju është dhënë është rreth 4 milionë euro, për mbajtjen ashtu siç duhet të këtij pozicioni Shqipërisë, në një kohë që do t'ju duhen rreth 10 milionë euro, me atë që unë di. Kjo do të thotë që diferenca prej 6 milionë eurosh nuk janë qindarka për një buxhet të një vendi. Në fakt, ne do të vendosim në diskutim aktet normative që do të vijnë në mes të vitit tjetër, lidhur me mundësinë apo pamundësinë buxhetore për ta plotësuar këtë shumë parash. Prandaj ne nuk do të mjaftohemi vetëm me premtimin që qeveria apo Ministria e Financave ka thënë se mes të vitit tjetër do të riallokohen disa fonde të tjera, për dy arsye kryesore. E para, riallokimet bëhen për shkak të mosrealizimit të investimeve dhe për aq kohë sa ne nuk e dimë se si do të jetë realizimi i vitit tjetër, nuk mund të dimë sesi mund ta kemi riallokimin. Pra, mund të kemi problematika të tjera, të cilat mund të dalin rrugës dhe nuk mund t'i parashikojmë, prandaj e mira do të ishte që të paktën tre të katërtat e kësaj shume të ishte që sot në buxhetin e shtetit.

Ne jemi këtu jo vetëm për të bërë pyetje, por edhe për t'ju mbështetur. Unë besoj se këtu ndaj edhe mendimin e shumë kolegëve të tjerë, për të mos thënë të gjithëve, që të dalim me një kërkesë, të cilën do t'ia paraqesim Komisionit të Ekonomisë për të mundësuar një tjetër buxhet për Ministrinë e Europës dhe Punëve të Jashtme këtë vit, meqenëse është realisht një vit i rëndësishëm për Shqipërinë, e cila merr për herë të parë presidencën e OSBE-së. Por edhe punët e tjera që kemi në vazhdim, nuk janë më pak të rëndësishme, si procesi i hapjes së negociatave, lobimi për marrjen e një vendi jo të përhershëm në Këshillin e Sigurisë e kështu me radhë. Pra, këto gjëra duhet të planifikohen që sot, pavarësisht që duket sikur viti 2024 vjen më vonë, ne duhet të fillojmë që tani të përgatitemi për këtë gjë.

Në fakt, doja të bëja pyetje, por më doli koment. E di që 4 milionë euro nuk mjaftojnë, kjo shumë shërben për të filluar disa punë, por nuk mjafton, prandaj kjo është oferta jonë për ju.

Jeni të lutur t'u përgjigjeni të gjithë pyetjeve që u bënë pastaj të kalojmë në diskutime.

Faleminderit!

Fjala për ju.

Gent Cakaj – Faleminderit!

Në fakt, janë një sërë pyetjesh me përmbajtje politike, prandaj po u shmangem, sepse nuk lidhen drejtpërdrejt me çështjen e buxhetit.

Fillimisht dua të sqaroj faktin se përse nuk i jam përgjigjur pozitivisht ftesës së parë për të qenë i pranishëm në këtë komision. Kjo nuk lidhet me neglizhencën time në raport me komisionin, por kjo është si pasojë e kalendarit të ngjeshur dhe agjendës së ngarkuar me shumë aktivitete. Unë jam në dispozicionin tuaj për të ofruar të gjitha sqarimet e nevojshme.

Së dyti, një prej pyetjeve ishte nëse kemi ndonjë vlerësim të saktë se sa përputhet niveli i shpenzimeve financiare me performacën e ambasadave dhe nëse duhen mbyllur disa ambasada, meqenëse nuk justifikojnë as shpenzimet e tyre. Kjo është një çështje që kërkon një analizë më të detajuar të punës dhe diskutim për ambasadat e veçanta.

Por meqenëse diskutuat për nevojën e rritjes së numrit të ambasadave, janë dy vendime, të cilat kanë qenë publike dhe mund t'ju informoj. Vendimi i parë për hapjen e ambasadës në Kanberra dhe i dyti për hapjen e misionit në Ukrainë, i cili lidhet drejtpërdrejt me angazhimet që kemi në kuadër të kryesisë së OSBE-së.

Për sa i përket pyetjes për koordinimin me Ministrinë e Diasporës, e cila ishte një pyetje e rëndësishme, natyrisht që koordinimi ekziston për shkak se objektivat tanë janë të përbashkëta dhe për rrjedhojë kjo nuk është çështje e zgjedhjes individuale, por është më shumë diktat i rrjedhjes objektive të punës.

Në fund, për sa i përket mjaftueshmërisë së fondeve për kryesimin e OSBE-së, është e vërtetë që 4 milionë nuk janë të mjaftueshëm për përmbylljen e kryesisë shqiptare të OSBE-së, por është një pikë fillestare që mundëson organizimin e konferencave dhe shpenzime të tjera në shërbim të aktiviteteve politike dhe një pjesë të shpenzimeve operative. Por duhet theksuar se për organizimin e ministralit në fund të vitit të ardhshëm do të ketë një buxhet shtesë, i cili do të ndahet nga qeveria në mënyrë që të përballohet me sukses i gjithë vëllimi i punës që do të shfaqet.

Është e rëndësishme të theksohet që llogaritjet për kryesimin e OSBE-së nuk mund të paracaktohen, sepse nuk janë fikse. Shpenzimet janë dinamike dhe për rrjedhojë fakti që nuk ka një pasqyrim më të detajuar të buxhetit ose një masë më të madhe parash, nuk tregon mungesë gatishmërie politike, por është pasqyrë e faktit që edhe buxheti duhet të plotësohet paralelisht me rritjen e vullnetit të punës. Ajo që unë mund të konfirmoj është se qeveria e Shqipërisë gëzon vullnetin e plotë për të mbështetur financiarisht kryesinë kombëtare të OSBE-së, ngaqë është prioritet i padiskutueshëm qeveritar dhe kombëtar.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Kalojmë në diskutime. Kush e do fjalën?

Fjalën e ka ish-ministri Bushati.

Ditmir Bushati – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit edhe për sqarimin procedural që bëtë në fillim të kësaj seance, të cilën unë e çmoj si shumë të rëndësishme, sepse çdo vit ne e kemi filluar diskutimin për buxhetin me një përfaqësues të lartë të Ministrisë së Financave dhe më pas Ministria Jashtme në rastin e sotëm apo ministri për Diasporën në rastin e djeshëm kanë mundësi për të na bërë një pasqyrë më të qartë të institucioneve, të cilat ata mbulojnë. E them këtë, sepse edhe në diskutimet që u shtruan dje, për sa i përket koordinimit të institucioneve brenda suazës të Këshillit të Ministrave, por edhe për sa i përket diskutimit të sotëm, si për kryesinë e OSBE-së apo prioritete të tjera, na ndihmojnë ne për të pasur një ide më të qartë dhe e dyta për ta vendosur edhe Ministrinë e Financave, në rastin në fjalë, në lartësinë që duhet të ketë kryesia shqiptare e OSBE-së. Prandaj zonja kryetare, do të ishte mirë që ne të kishim të paktën një zëvendësministër dhe drejtorin e buxhetit nga Ministria e Financave, ashtu siç e kam parë në të gjitha komisionet e tjera, sepse e kam thënë, pavarësisht pozicionit që kam pasur dhe e them sot përsëri se Komisioni i Politikës së Jashtme në çdo parlament demokratik është “komisioni i esnafëve”. Pra, është ai komision, nëse do t’i referohemi Parlamentit European, sepse po shikoj buzëqeshje nga miku im nga Skrapari atje, në rast se do t’i referohemi edhe renditjes...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, nëse i referohemi edhe renditjes që bëhet në Parlamentin Europian apo në vende të tjera e tillë është. Pra të paktën do të kemi mundësi për ta risjellë këtë praktikë vitin tjetër kur të

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, të hënën është nen për nen, por për ta rikuperuar vitin tjetër, sepse në fund të ditës përpara se të jemi anëtarë të këtij komisioni, ne jemi deputetë, politikanë dhe kemi të drejtë për t’i bërë pyetje Ministrisë së Financave për drejtimet kryesore të buxhetit, për investimet, për mënyrën se si janë zbatuar politikat kryesore gjatë vitit që shkoi dhe pse po shkojmë në këtë drejtim, pra për të krijuar edhe ne idenë tonë nëse duhen më shumë fonde për një sektor që e mbulon ministria në fjalë apo duhet për diçka tjetër.

E dyta, dua që ta mbështes buxhetin që ka ardhur për Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe besoj se çdo zë apo përpjekje jona për të fuqizuar shërbimin e jashtëm, përveçse është prioritar, edhe është në përputhje me angazhimet që ka marrë Shqipëria, për sa i përket OSBE-së, por jo vetëm. Mendoj se ka ardhur koha që trupa jonë të jetë edhe më e incentivuar.

Kolegu Bushati foli për sa i përket rritjes së pagave që ne kemi bërë për njerëzit në shërbimin e jashtëm dhe besoj se është bërë një rritje thelbësore, por gjithsesi në rast se shikojmë mënyrën se si paguhet, incentivohet apo buxhetohet e gjithë jeta jonë diplomatike. Përsëri duhet të them që Shqipëria ende nuk e ka bërë kapërcimin e domosdoshëm që duhet ta bëjë, si në funksion të perspektivës së anëtarësimit në Bashkimin Europian, por edhe të një zëri gjithnjë e më në rritje në arenën rajonale dhe përtej arenës rajonale.

Më specifikisht dua të them se ekziston e gjithë ekspertiza e nevojshme pranë shërbimit të jashtëm. Ju ftoj me modesti që të heqim dorë nga debati mbi shifrat, se sa kushton një kryesi, sepse një kryesi përgjithësisht kushton në përputhje me vetë specifikën që ka vendi, por edhe me rrethanat dhe kontekstin gjeopolitik. Besoj se fondi i alokuar është një fond i mirë për momentin, nuk ka një çmim as dysHEME dhe as tavan se sa mund të kushtojë një kryesi. Unë besoj se më i rëndësishëm se debati për shifrat është debati për prioritetet tona. Ne duhet ta shikojmë këtë kryesi si një prioritet kombëtar.

Është inkurajues fakti, siç ka deklaruar publikisht Kryeministri, që ai do të jetë njëkohësisht kryetari i radhës së OSBE-së, sepse është një garanci për efektivitet më të madh për t'i përfshirë të gjitha institucionet në këtë proces, pra për t'i kyçur. Kujtoj që Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Shërbimi Informativ, parlamenti nuk diskutohet dhe instanca të tjera, por edhe sektori civil, duhet ta ndiejnë veten pjesë e këtij procesi.

Gjithashtu, shpresoj shumë që duke filluar nga viti tjetër klima politike në Shqipëri të jetë më e paqtë dhe më bashkëpunuese për ta konceptuar si një koncept mbarë kombëtar.

Çështja e tretë, për të cilën mbase do të kemi një diskutim kur ta shqyrtojmë nen për nen, ka lidhje me prioritetet apo nënprioritetet.

Jam dakord me të gjithë kolegët, ashtu siç ramë dakord edhe dje me ministrin për Diasporën, që në relacionin tonë të japim mbështetje për ato kërkesa specifike që kishte ministri.

Për sa i takon Ministrisë së Jashtme, edhe pse nuk u artikulua në mënyrë konkrete, besoj se është domosdoshmëri nga ana jonë që t'i krijojmë të gjithë konfortin e duhur qeverisë dhe Ministrisë së Jashtme që në çdo moment që është e domosdoshme të ketë një rishikim të buxhetit në funksion të përmbushjes së prioritetëve që duhet të ketë Shqipëria. Për shembull, vjet në seancën kur kemi miratuar buxhetin, me propozim të Kryeministrit, është shtuar një fond prej 1 miliard lekësh apo 1 milion eurosh për sa i përket një studimi që duhej bërë për bashkimin e shqiptarëve dhe një procesi ku duhet të përfshiheshin shumë shoqata, *think - tanke* apo konsulentë nga më të ndryshëm për të hapur një debat për këtë proces, i cili është mjaft madhor, i komplikuar dhe kërkon pjekurinë dhe qetësinë e

nevojshme. Në këtë kontekst do të ishte mirë që këto hapësira, sepse në dijeninë time ende nuk ka një studim për këtë gjë, mund t'i përdorë fare mirë qeveria, Ministria e Jashtme edhe në funksion të rishikimit që do të pësojë buxheti gjatë vitit tjetër.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, ne e themi shpesh, edhe pse unë përgjithësisht nuk e kam qejf termin “lobim” dhe përpiqem ta evitoj, në rast se ka një gjë për të cilën ne duhet të tregojmë kujdes maksimal, njësoj si kujdesi që duhet të kemi ndaj luleve, pra t'i ujisim dhe t'i ushqejmë me përbërësit e domosdoshëm për t'u rritur që më pas të marrim frytet, janë kapacitetet administrative.

Mendoj që shërbimi dhe kryeqytete specifike kanë nevojë për t'u fuqizuar. Nuk do t'i marrim dot frytet menjëherë, sepse ky është një proces që kërkon kohën e nevojshme, por siç e kam thënë edhe në mbledhjet e tjera kur është ngritur si çështje, mendoj që pjesa e burimeve njerëzore është përgjegjësi ekskluzive e ministrisë dhe qeverisë. Ky komision mund të jetë ose jo dakord për politika të caktuara që mund të ndjekë qeveria, por nuk ka tagër për t'u marrë me çështjet e burimeve njerëzore. Ne mund të diskutojmë në princip për këtë gjë. Besoj që praktika që po ndiqet me OSBE-në, ku merren njerëz jashtë shërbimit, por që kanë ekspertizë të posaçme, në gjykimin tim duhet të mbështetet më tej, sepse periudha është mjaft e shkurtër dhe është e vështirë që në 1, 2 apo 3 vjet, që ne do të jemi në Trojkë, ne të konsolidojmë përfundimisht burimet njerëzore. Kjo është një çështje, të cilën ne mund ta mbështesim këtu në trajtën e një rezolute në kuptimin politik dhe në kuptimin financiar me buxhet, që duhet më tej për shërbimin e jashtëm. Më pas, mënyra si riallokohen stafet në varësi të nevojave është një çështje ekskluzivisht e Ministrisë së Jashtme. Mendoj që nuk mund jetë dhe nuk duhet të jetë çështje jona.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti ish - ministër!

Përpara se t'ia jap fjalën zotit Karamelo, ndryshe nga ish-ministri Bushati, unë besoj që shifrat janë të rëndësishme. Madje, ne mund të flasim sa të duam në teori, por pa shifra dhe para nuk shkojmë dot askund. Për fat të keq i ka qëlluar një kolege që është financiere me *background*. Gjithmonë më pranë meje do të jenë shifrat sesa politika e madhe. Është çështje profesionale dhe prandaj është çështje këndvështrimesh.

Zoti Karamelo, fjala është për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, të lutem.

Ditmir Bushati – Nuk thashë që shifrat s'janë të rëndësishme, por thashë që shifrat janë instrument në funksion të përmbushjes së prioriteteve.

Mimi Kodheli – Fakti që flasim për shifra ditën e buxhetit është risi.

Po, zoti Karamelo.

Ligoraq Karamelo - Faleminderit, zonja kryetare!

Meqenëse në përgjithësi ish-ministri foli politikisht, edhe unë do të mbaj pak anën e trajtimit politik të buxhetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe shifra ka rëndësi, zonja kryetare, sepse këtu po flasim për shifra.

Po e nis mendimin tim me integrimin e vendit dhe hapjen e negociatave. E theksova këtë fakt, zoti Ministër, sepse vitin e kaluar Shqipëria përjetoi një moment disi rëndues; priste hapjen e negociatave, por ato nuk u hapën. Pavarësisht faktorëve që ndikuan dhe si u interpretua, unë gjykoj që edhe Ministria e Jashtme ka përgjegjësinë e saj në këtë drejtim.

Për sa i përket objektivit që ju keni vendosur për vitin që vjen prisja të shikohej me sy kritik puna që është bërë, të metat dhe ku do të konsistojë konkretisht gjatë vitit të ardhshëm puna e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme në drejtim të procesit të hapjes së negociatave.

Së dyti, prisja pozicionimin tuaj për sa i përket efektivitetit të shërbimit diplomatik, sepse nuk më vjen mirë që ju si ministri ende nuk keni një studim ku të përcaktoni efektivitetin e ambasadave dhe cilat janë ato që duhen mbyllur. Padyshim që më vjen shumë mirë dhe përgëzoj iniciativat për hapjen e njësive të reja diplomatike, kjo tregon që është një hap shumë pozitiv, por fakti është që kemi ambasada që vegjetojnë, që nuk bëjnë asgjë, por që qëndrojnë. Mungon studimi për të hapur apo për të mbyllur ambasada në një kohë që kryhen veprime për *show*, duke hequr pasaporta diplomatike apo duke pushuar njërin apo tjetrin, për të treguar që diçka do të bëhet. Për mua reformë është rruga si do të vazhdojë shërbimi diplomatik: Ku do të jenë ambasadat? Çfarë prioritetesh do të kenë? Cili do të jetë efektiviteti i punës së tyre?

Së treti, dua të trajtoj çështjen e kryesimit të OSBE-së nga Shqipëria. Nga njëra anë ju thoni që aktivitetet nuk mund të programohen, nga ana tjetër thoni që fondi që kemi është i paktë. Kjo mënyrë e trajtimit nuk më pëlqen. Në qoftë se duam të jemi seriozë në këtë drejtim, është më mirë të mos hartojmë fare një projektbuxhet dhe t'ia lëmë rastësisë, në të kundërt të bëjmë një buxhet të përafërt me atë që ne mendojmë dhe të themi që shpresojmë që kaq do të jenë shpenzimet, por ama në fund fare na duhet edhe pesë lekë për ta mbyllur këtë.

Së fundi, unë e mbështes kryetaren për sa u takon shifrave. Mbështetja diplomatike jashtë vendit ka një rritje të fondit të pagave. Kërkova një sqarim pse është kjo rritje në një kohë që ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rrogat e kujt?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për sa i përket aktivitetit diplomatik dhe konsullor nuk ka rritje as në numër punonjësish dhe asgjë.

Mimi Kodheli – Zoti Karamelo, nuk jam në atë pozicion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, ka të bëjë me shifrën, me zanatin, jo krahun. Shifra nuk ka krah.

Ligoraq Karamelo – Unë nuk e kuptoj pse kjo nuk është tek tabela e katërt, meqë ka të bëjë me pagën dhe problemet e personelit.

Mimi Kodheli – Nuk ka të bëjë me problemet e personelit, sepse personeli mbetet i njëjtë në numër. Rritet vetëm fondi i pagave për shkak të efektit që ka pasur miratimi i rritjes së fondit të pagave që nga ky vit. Nuk ka të bëjë me strukturën, por vetëm me rritjen e fondit të pagave, prandaj është në zërin “fond pagash” dhe jo në zë tjetër.

Ligoraq Karamelo – Këtu thuhet: “mbështetja diplomatike jashtë vendit ka edhe shpenzime operative”. Çfarë lidhje ka kjo me pagat?

Dakord, unë nuk jam ekonomist dhe nuk marr vesh, por kaq gjëra i kuptoj.

Mimi Kodheli – Zoti Karamelo, të paktën unë dhe ju ruajmë të drejtën që zoti Cakaj të mund të vij në këtë komision për të folur në detaje për programet, aktivitetet, mënyrën e organizimit dhe buxhetimin për vitin që vjen të Shqipërisë Presidente e radhës e OSBE-së. Ndaj, e riftoj zotin Cakaj, ia ripërsëris ftesën, që kjo gjë të bëhet e mundur në momentin më të parë të mundshëm në axhendën e tij dhe tonën.

Për sa i përket idesë së shifrave, nëse unë them që janë caktuar 4 milionë euro, por duhen 10, këtë e kam për shkak të një eksperience të caktuar që të di se sa mund të rrijë kjo pak a shumë në një vend të vogël si Shqipëria. Mund të jetë 12 apo edhe 9, por ne po flasim shumë makro dhe në mënyrë shumë aproksimative për atë kohë sa nuk e kemi të detajuar këtë program.

Fjala për zotin Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Si relator dhe anëtar i Komisionit të Ekonomisë, bashkë me kolegen Kushi do të argumentojmë nëse do të duhet që tre apo katër nga këto diskutime të mbështeten edhe financiarisht.

Dua të ndaj tri argumente, të cilat nuk janë hierarkike.

Së pari, jam shumë dakord dhe mbështes kërkesën e deputetit Sterjovski. Ne kemi bërë një punë shumë të mirë me miratimin e ligjit për minoritetet, kështu që duhet të parashikohet edhe pjesa e ndërtimit të urave të komunikimit dhe të hapjes pse jo të një pike tjetër doganore.

Ne do të përfitojmë nga pikëpamja diplomatike, politike, por edhe financiare, sepse lidhemi me një shtet me të ardhura më të larta për frymë sesa ne. Kjo ndikon në turizëm dhe në shkëmbimet tregtare. Patjetër ka edhe elementin njerëzor që mundëson komunikimin për çdo nevojë që mund të kenë, aq më tepër që tani kufijtë janë drejt heqjes. Kështu që, patjetër të shikohet edhe kjo.

Meqë jemi te urat e komunikimit, ka ardhur momenti që diaspora shqiptare apo edhe minoritetet të jenë në funksion të kapitalit diplomatik dhe politik. Ne sot kemi shqiptarë në të gjithë Europën (po krijohet gjenerata e dytë), shumë prej të cilëve janë të shkolluar, janë në politikë, por edhe kanë kandiduar për këshilla rajonale, bashkiakë, siç ka edhe deputetë shqiptarë. Patjetër që ky është një kapital. Nuk duhet të vazhdojmë me mendësinë e ... Le të jepen edhe abetare dhe të ketë momente të ndërgjegjësimit që janë shqiptarë, por mund të shfrytëzohen, sepse kanë një gravitet të madh në zonat ku janë, për të qenë kapital politik dhe për të avancuar dhe çështjen e Shqipërisë. Në qoftë se 70 mijë shqiptarë në Suedi bëjnë një petition ndaj Kryeministrit apo 400 mijë shqiptarë në Itali bëjnë një petition ku mbështesin çështjen tonë për integrimin, këta janë një kapital politik. Nëse ne si deputetë do të na vijne dhjetë letra nga një zonë e caktuar elektorale, ne do të bëjmë namin në Kuvend. Imagjino t'i kishin shkuar Presidenti të Francës nga qytetarë shqiptarë votues francezë në mbështetje të kauzës sonë. Pra, duhet menduar kjo urë komunikimi.

Së dyti, patjetër që duhet të ketë mbështetje kërkesa që bën edhe kryetarja në qoftë se do të duhet të ketë fonde shtesë, por ne duhet të jemi të përfshirë më shumë në këtë proces. Kuvendi, në këtë rol politik që merr Shqipëria në drejtimin e OSBE-së, duhet të jetë lider. Jemi Republikë Parlamentare dhe duhet të na vijë një axhendë e saktë se çfarë do të bëhet me këtë punë: si mund të përfshihet parlamenti, kush duhet nga Komisioni i Jashtëm, si mund të ndikojë më shumë. Ne të gjithë kemi marrëdhënie shumëpalëshe, dypalëshe, Këshillin e Europës, delegacionet tona në NATO. Të gjitha këto janë ura komunikimi për të rritur

efektivitetin dhe në fund të ditës peshën tonë për të arritur atë që e kemi prioritet kryesor, anëtarësimin në Bashkimin European.

Pika e tretë ka të bëjë me lobimin pozitiv. Lobimi nuk është fjalë e keqe, por shumë pozitive. Ne duhet të avancojmë çështjen tonë kombëtare për të qenë në Bashkimin European sa më shpejtë. Ne jemi pjesë e Europës, por duhet të jemi edhe e Bashkimit European, sepse jemi europianë. Kemi parë që 2-3 vende euroskeptike, jo për shkak të Shqipërisë, sepse 25 vende të tjera kanë qenë pro hapjes së negociatave, për shkak të politikave të brendshme të tyre kanë qenë më skeptike me avancimin e Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë në axhendën e tyre drejt Bashkimit European.

Atëherë çfarë duhet të bëjnë ambasadat që ne kemi në këto vende? Të bëjnë një proces lobimi apo për të tamponuar në kohë, në qoftë se do të ketë vende të tjera që do të fillojnë të tregohen më euroskeptike? Lëvizjet politike sipas zgjedhjeve që kanë i bëjnë ata që të kthehen edhe në euroskeptike. Unë e di që ka një plan dhe janë ambasadorët për 2, 3 apo 4 vjet, por nëse do të duhet të rishikohet politika jonë pozitiviste e promovimit, e lobimit dhe e të çuarit të një stafi më të specializuar, pse jo të shtohen edhe numrat në këto ambasada.

Ne e dimë dhe po e shikojmë që ambasada të rëndësishme në këtë proces bëhen Berlini dhe Parisi. Për sa i përket Brukselit, unë mendoj që ata duan që Europa të zgjerohet. Ata llojnë vetë që të rrisin peshën e tyre. Në Bruksel janë të bindur për këtë punë, sepse Komisioni European e ka dhënë vendimin. Unë mendoj që në disa shtete të caktuara duhet rritur pesha, si për shembull në Berlin apo Paris. Të mos u hyjmë edhe vendeve të tjera, por nëse do të shikojmë që mund të ketë kontaminim, patjetër që duhet bërë një proces tamponimi edhe në dy-tre vende të tjera afër këtyre vendeve që mund të kërkojnë mbështetje për të avancuar axhendën e tyre. Për këtë punë duhet të tregohet fleksibël, strategjike dhe e shpejtë Ministria e Jashtme në mënyrë që t'i paraprijmë, sepse ndoshta në pranverë do të kemi një rishikim të vendimit, për të cilin unë mendoj që do të jetë pozitiv. Ky është përsëri mendim personal.

Pra, duhet rishikuar mënyra e funksionimit të disa ambasadave, që do të jenë pika kyçe në vazhdimësi. Pra, gjithmonë e më shumë Bashkimi European ka një proces që shkon drejt politikave të brendshme që shkojnë në Bruksel. Në Bruksel është fakt i kryer; Polonia, vendet e Vishegradit. Pra, duhet parë në këtë sens. Patjetër të koordinojmë me Maqedoninë, Serbinë, Malin e Zi, njësoj siç kanë bërë vendet e Vishegradit, për të pasur një front avancues pozitiv drejt Bashkimit European.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegë!

Nëse nuk ka diskutime të tjera, unë mendoj që këtu ta mbyllim diskutimin. Ju njoftoj që ditën e hënë, në orën 09:00 do të kemi diskutimin nën për nën, pra detaje të tjera lidhur me shpenzimet buxhetore për vitin në vazhdim të ministrisë.

Ju ftoj, zonja Dega dhe zoti Skapi, dhe i bëj një kërkesë ministres Denaj që të sjellë të paktën një zëvendësministër për ditën e hënë, që të mund të jeni të gatshëm për çdo sqarim të mundshëm.

Ju falënderoj, zoti Cakaj, për praninë!

Shihemi të hënë, kolegë. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA

